



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Përmbajtja

<u>Politika e Privatësisë</u>	2
<u>Qëllimi dhe Fushëveprimi</u>	2
<u>Kush është përgjegjës për përpunimin e të dhënave tuaja?</u>	2
<u>Kategoria e të dhënave që përpunohen</u>	2
<u>Për çfarë qëllimi përpunohen të dhënat tuaja personale</u>	3
<u>Baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale</u>	3
<u>Me kë mund t'i ndajmë të dhënat personale të mbledhura</u>	3
<u>Të drejtat tuaja si subjekt i të dhënave</u>	3
<u>E drejta e ankimit</u>	4
<u>Siguria e të dhënave</u>	4
<u>Përditësimi i politikës</u>	4
<u>Politika për Cookies</u>	4

Institucioni i Avokatit të Popullit- IAP

Politika e Privatësisë

Qëllimi dhe Fushëveprimi

Kjo politikë shërben për të informuar se si ruhen dhe përpunohen të dhënat personale kur grumbullohen si pjesë e nevojshme e proceseve të punës dhe kushteve të bashkëpunimit në subjekte tjera në kuadër të ushtrimit të mandatit të IAP. Kjo politikë zbatohet për të gjithë personave fizikë, përfshirë :palë ankuese; aplikantë për punë; persona që marrin pjesë në aktivitete të organizuara nga IAP; përfaqësues të institucioneve publike; përfaqësues të OShC-ve dhe vizitorë të faqes zyrtare që ndërveprojnë me përmbajtjen apo shërbimet e IAP-së , si dhe të punësuarit në IAP.

Kjo politikë është hartuar në zbatim të detyrimeve që dalin nga Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe autorizimeve nga Ligji nr. 05/L-019 Ligji për Avokatin e Popullit, në raport me rregullat për sigurinë e të dhënave personale dhe konfidencialitetit, si dhe në pajtim me legjislacionin evropian për mbrojtjen e të dhënave personale.

Kush është përgjegjës për përpunimin e të dhënave tua?

Përpunues dhe kontrollues i të dhënave personale është:

Institucioni Avokatit të Popullit – Republika e Kosovës

Adresa: Rr. “Migjeni” nr. 21, 10000 Prishtinë

Web: <https://oik-rks.org>

Email: info@oik-rks.org

Tel: +383(0)38 223 782, 223 783, 223 784

Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (ZMDHP), është i emëruar në IAP dhe mbikëqyr ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave. Për çdo shqetësim apo kërkesë lidhur me privatësinë, mund të kontaktohet ZMDHP në adresën: merita.gara@oik-rks.org .

Kategoria e të dhënave që përpunohen

Avokati i Popullit përpunon vetëm ato të dhëna që janë të domosdoshme për përmbushjen e mandatit kushtetues dhe ligjor:

- Emër, mbiemër, numër identifikues personal, adresa, email, numër telefoni;
- Të dhëna që përmbajnë ndjeshmëri të veçantë (p.sh. të dhëna shëndetësore, të dhëna që zbulojnë përkatësi etnike, fetare, politike ose përkatësi të komuniteteve);
- Informacione që lidhen me përmbajtjen e ankesës apo parashtresës;
- Foto/video nga ngjarjet publike të organizuara nga institucioni.

Si dhe të dhëna të tjera të kërkuara sipas ligjeve të veçanta që rregullojnë marrëdhëniet e punës ose marrëdhëniet kontraktuale, procedurën e rekrutimit.

Për çfarë qëllimi përpunohen të dhënat tuaja personale

Të dhënat personale përpunohen për qëllimet në vijim:

- Përmbushja e detyrimeve në trajtimin e ankesave dhe ushtrimi i mandatit të Avokatit të Popullit sipas Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit;
- Mbajtja e kontaktit me palët dhe ndjekja e procedurave hetimore;
- Përmbushja e detyrimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Rregulloren e Përgjithshme të Bashkimit Evropian për mbrojtjen e të dhënave personale.(GDPR)
- Organizimi i aktiviteteve publike, trajnimeve, konferencave dhe fushatave për ngritje të vetëdijes;
- Menaxhimi i kërkesave për qasje në dokumente publike sipas Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në dokumente Publike;
- Përmbushja e detyrimeve ligjore dhe institucionale, përfshirë ruajtjen dhe arkivimin sipas ligjit.

Baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale

IAP i përpunon të dhënat personale në përputhje me:

- Ligjin Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit;
- Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Ligjin Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike;
- Ligjin për Arkivat Shtetërore;
- Në disa raste, përpunojmë të dhënat personale vetëm pas pëlqimit paraprak të subjektit të të dhënave. Pëlqimi i dhënë mund të tërhiqet në çdo kohë nga subjekti.

Me kë mund t'i ndajmë të dhënat personale të mbledhura

Të dhënat tuaja personale nuk u zbulohen palëve të treta përveç:

- Autoriteteve kompetente gjyqësore, hetimore ose mbikëqyrëse, nëse kërkohet me ligj apo për interes publik;
- Palëve të përfshira në rastin konkret,

Gjithnjë, duke pasur parasysh dhe në përputhje me rregullat e konfidencialitetit dhe parimin e proporcionalitetit, të mbështetura me Ligjin për Avokatin e Popullit dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Të drejtat tuaja si subjekt i të dhënave

Kur të dhënat tuaja personale përpunohen nga IAP, ju keni të drejtë:

- Të kërkonit qasje në të dhënat tuaja personale;
- Të kërkonit përmirësim ose përditësim të tyre;

- Të kërkonti fshirjen e të dhënave në rrethana të caktuara (e drejta për t'u harruar);
- Të kërkonti kufizimin e përpunimit;
- Të ankoheni në çdo kohë nëse besoni se të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave janë shkelur

E drejta e ankimit

Në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, çdo person fizik që beson se i është shkelur e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale, mund të paraqesë ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi me adresë: Rr. Zejnel Salihu - Nr.22, 10000, Prishtinë, e-mail: info.aip@rks-gov.net,

Siguria e të dhënave

Institucioni zbaton masat e duhura fizike, organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat tuaja personale në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Kohëzgjatja e ruajtjes së të dhënave personale varet nga qëllimet e përpunimit për të cilat ato janë mbledhur dhe është e rregulluar me Ligjin përkatës për Arkivat Shtetërore, Ligjin për Avokatin e Popullit ose me ndonjë ligj tjetër përkatës.

Përditësimi i politikës

Ne mund të përditësojmë herë pas here politikën tonë të privatësisë dhe do t'ju njoftojmë për çdo ndryshim duke postuar Politikën e re të privatësisë në këtë faqe.

Faqja e internetit mund të përmbajë linqe të ndryshme të faqeve të tjera të internetit, për të cilat ju rekomandojmë të i lexoni politikat e privatësisë të faqeve të tyre.

Politika për Cookies

Faqja e internetit e Institucionit të Avokatit të Popullit përdor cookies për të përmirësuar përvojën e përdoruesve, për të mundësuar funksione bazike të faqes dhe për të analizuar mënyrën e përdorimit të faqes nga vizitorët.

Cookies janë skedarë të vegjël që ruhen në pajisjen tuaj për të ndihmuar në ruajtjen e preferencave ose për të ndjekur aktivitetin e navigimit në faqen tonë. Kur hyni në faqen tonë, mund të merrni një njoftim që ju kërkon pajtimin për përdorimin e cookies.

Ne përdorim vetëm cookies të domosdoshme për funksionimin bazik të faqes. Nuk përdorim cookies për marketing apo ndjekje të sjelljes pa pëlqimin tuaj të qartë.

Nëse nuk pajtoheni me përdorimin e cookies, ju mund t'i çaktivizoni ato përmes shfletuesit tuaj. Megjithatë, kjo mund të ndikojë në funksionimin e disa pjesëve të faqes.